



Shkodër, Maj 2020
SHOQATA “INTELEKTUALËT E RINJ, SHPRESE”

MONITORIMI I BASHKISË SHKODËR

NË LIDHJE ME MASAT E NDËRMARRA NË KUADËR TË PANDEMISË COVID – 19



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**



**Suedi
Sverige**

TABELA E PËRMBAJTJES

3 SHKURTIME

3 FALENDERIME

4 HYRJE

5 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

7 ANALIZË E GJETJEVE

Bashkia Shkodër

Këshilli Bashkiak

Intervistat me qytetarët

16 REKOMANDIME

17 ANEKSE

Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Ky raport është Përgatitur nga shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" në kuadër të projektit POP 2020 "Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal" të mbështetur nga Olof Palme Centre International, përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Suedeze ose të Olof Palme International Centre.

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë mbylljes së pazakontë për shkak të pandemisë COVID-19 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Shkodër për përgjigjen e shpejtë brenda afatit kohor duke na vënë në dispozicion informacionet e kerkuara. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center, për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "*Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)*" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Rrjeti "*Përballja e Ofertave Politike – POP*", synon të rrisë debatin publik dhe përçojë informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "*Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social*". Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- "Epoka e Re", Fier;
- "Intelektualët e Rinj, Shpresë", Shkodër;
- "Lëvizja Rinore për Demokraci", Pukë;
- "Qendra Rinore për Progres", Kukës,
- "Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim", Pogradec.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "*Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal*." Gjatë fazës së parë të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Por, mes situatës së krijuar nga COVID-19, anëtarët e rrjetit POP përshtatën aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit që këto organizata përfaqësojnë.

Gjatë muajve Mars dhe Prill 2020, organizatat patën si qëllim:

- Të monitorojnë Këshillat Bashkiakë dhe veprimtarinë e bashkive për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojnë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojnë dhe advokojnë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, organizatat anëtare të POP u bazuan në metodat më poshtë:

1. Në çdo bashki u dërgua një letër-kërkesë për informacion. Përgjigjet e kësaj letre janë në pjesën e analizimit të gjetjeve
2. U realizuan disa intervista cilësore me banorë të njësive të ndryshme, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparëshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioritetëve të Kontratës Sociale.
3. U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
4. U monitoruan vendimet e keshillave bashkiakë në lidhje me masat e vetë bashkisë në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të keshillave bashkiakë.

Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Shkodër, të kryer nga shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" më poshtë disa nga gjetjet.

Gjetje nga përgjigjet e Bashkisë:

- 1824 familje janë trajtuar me ndihmë ekonomike gjatë muajit Mars (1639 familje nga sistemi dhe 185 familje nga fondi 6%).
- Në muajin Mars, 32 familje më pak se në muajin Shkurt janë trajtuar me ndihmë ekonomike në muajin Mars
- 4363 është numri i personave që trajtohen me KEMP nga të cilët pa aftësi fizike 2568, kujdestarë të të pa-aftëve 475, të verbër 520, kujdestarë të të verbërve 132, tretraplegjikë/paraplegjikë 337, kujdestarë të tyrë 331.
- 3401 invalidë pune për muajin Mars janë trajtuar me shtesë kempit. Nga këta 2485 i përkasin qytetit Shkodër.
- Thirrja për aplikime për programet e strehimit social, për shkak të situatës emergjente të shkaktuar nga COVID-19, është pezulluar deri në një datë për t'u përcaktuar. Si rezultat i kësaj situatë edhe programi i bonusit të strehimit është i pezulluar, si pjesë e programeve të strehimit social
- 140 kërkesa janë bërë nga qytetarët pranë zyrave me një ndalesë në qendër dhe njësitë administrative për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Numri më i madh i kërkesave i përket njësisë Administrative Velipojë. Nga këto 34 objekte janë rradhitur sipas vlerësimit të pasqyruar në aktet e konstatimit, duke marrë në konsideratë shkallën e rrezikshmërisë dhe nevojën prioritare për ekspertizë të thelluar. Bashkia Shkodër i ka dërguar Prefekturës së Qarkut Shkodër informacion të detajuar për vlerësimin e ndërtesave publike dhe private, të dëmtuara gjatë tërmetit.
- 4 raste të reja të dhunës në familje janë trajtuar me urdhër mbrojtje.
- 135 familje të komunitetit rom të vendosur në vendqëndrimet pranë Prokurorisë, Zallit të Kirit, përtej Bunës, pranë lumit Drin, Tophanë dhe në Beltojë janë mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike.

- 352 familje egjiptiane të vendosura në lagjen Liria dhe përtej urës së Bunës janë mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike.
- 100 persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe në veshtiresi janë identifikuar të cilëve i janë afruar pako ushqimore dhe higjienike, shërbimin e blerjeve së produkteve të ndryshme sipas nevojës, informacion për procedurën e tërheqjes së pensionit, të sigurimit të medikamenteve, etj.
- 30 jetimë me dhe pa status janë mbështetur me produktet bazë të shportës por edhe me këshillim për femijët e tyre sipas nevojës.
- 2270 familje kanë marrë ndihma 1351 prej tyre jetojnë në zona urbane dhe 919 në zona rurale.
- Bashkia Shkodër nuk ka informacion për numrin e të rinjve të rikthyer nga jashtë në Shqipëri duke qenë se ky informacion nuk është dhënë nga Ministria e Brendshme apo Drejtoria e Kufirit.
- Bashkia komunikon në mënyrë të rregullt në lidhje me masat e marra nëpërmjet faqes internetit http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_155_1.php ose në rrjetin facebook <https://www.facebook.com/bashkiashkodres/>

Gjetje nga monitorimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak:

- 3 herë është mbledhur Këshilli Bashkiak Shkodër gjatë periudhës Mars-Prill
- Në mbledhjen e datës 23 Mars 2020 u miratua Vendimi nr.15, date 23.03.2020 "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2020
- Në mbledhjen e datës 03 Prill 2020 u miratua Vendimi nr.16, datë 03.04.2020 "Për Miratim Rezolute" për marrjen e masave të veçanta për shkak të situatës së krijuar si rezultat i Pandemisë të shkaktuar nga COVID-19
- Në mbledhjen e datës 23 Prill 2020 u miratua
 - Vendimi nr.17, datë 23.04.2020 "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri ne 6%) për muajin Mars 2020
 - Vendimin nr.18, datë 23.04.2020 "Për një ndryshim në VKB nr.26 dt.30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër"
 - Vendimin nr.20, datë 23.04.2020 "Për Ngritjen e Komisionit të Perkohshëm për Shqyrtimin e Model Rregulloreve"

Gjetjet nga intervistat e qytetarëve

Nga intervistat me kategoritë e caktuara rezulton se:

- 90% e të intervistuarëve të cilët punojnë në fasoneri theksojnë se nuk kanë masat e nevojshme parandaluese
- 68% e familjeve në nevojë shprehen se nuk kanë mjete financiare për të përballuar pagesat

- 85% e administratorëve të bizneseve shprehën se nuk përballojnë pagesat e qirave, taksat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e tyre.
- 55% e të punësuarve shprehën se kanë pasiguri në punë si dhe për të ardhmen e tyre
- 77% e personave me aftësi të kufizuara kërkojnë më tepër mundësi për të dalë në ajër të pastër.
- 65% e grave familjare kërkojnë më tepër liri dalje si dhe lehtësira në ofrimin e shërbimeve dhe pagesave.
- 88% e komunitetit Rom dhe Egjiptian shprehen se ndihmat nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë.
- 76% e studentëve/nxënësve shprehën se qëndrimi në shtëpi nuk krijon kushtet e duhura për t'u përqëndruar në studimin dhe përvetsimin e lëndëve. Mësimi online nuk e quajnë si të përshtatshëm në këtë kohë pandemie.
- 92% e sportistëve dhe artistëve të intervistuar ndihen të braktisur pa ndihmë financiare si dhe pa kushtet e duhura.
- 64% e pensionistëve vlerësojnë masat por kërkojnë më tepër hapësirë për të lëvizur në ajër të pastër.

Analizë e gjetjeve

Bashkia Shkodër

Ky raportim është bazuar në përgjigjet që Bashkia Shkodër i ka dhënë pyetësorit të dërguar në datë 07.4.2020. Bashkia Shkodër iu përgjigj pyetësorit brenda afatit kohor të përcaktuar nga ligji.

Gjatë muajit mars janë trajtuar me ndihmë ekonomike 1824 familje (1639 familje nga Sistemi dhe 185 familje nga fondi 6%). Në muajin mars, janë trajtuar me ndihmë ekonomike 32 familje më pak se në muajin shkurt.

Tabela 1: Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike

Nr.	Gjithësej nr. i familjeve që marrin ndihmë ekonomike	Në qytet/Në Nj.A	Burra/Gra	Statusi (i martuar/i divorcuar/ i ve/beqar me fëmijë)	Përshkrimi i situatës ekonomike, sociale dhe shëndetësore
	1856	424/1432	1561/295		

Tabela 2: Numri i personave që trajtohen me KEMP

Nr. i personave që trajtohen me KEMP	Burra	Statusi (i martuar/i divorcuar/ i ve/ beqar me fëmijë)	Gra	Statusi (e martuar/e divorcuar/ e ve/ beqare me fëmijë)	Jetojnë në zonë urbane/ rurale
4363	2574	-	1789	-	2274/2089

Të dhënat e mësipërme, i përkasin personave që janë trajtuar me pagesë paaftësie, nga të cilët, të paaftë 2568, kujdestarë të paaftë 475, të verbër 520, kujdestarë të të verbërve 132, tetra/paraplegjikë 337, kujdestarë të tyre 331. Për muajin mars 2020, janë trajtuar me shtesë kemp-i 3401 invalid pune. Nga këto 2485 invalid i përkasin qytetit Shkodër.

Thirrja për aplikime për programet e strehimit social për shkak të situatës emergjente të shkaktuar nga COVID-19, është pezulluar deri në një datë për t'u përcaktuar. Si rezultat i kësaj situatë edhe programi i bonusit të strehimit është pezulluar.

Tabela 3: Numri i familjeve që përfitojnë bonus qeraje

Nr. i familjeve që përfitojnë bonus qeraje	Burra /gra	Statusi (i martuar/i divorcuar/ i ve/ beqar me fëmijë)	Burra/ Gra	Statusi (e martuar/e divorcuar/ e ve/ beqare me fëmijë)	Jetojnë në zonë urbane/- rurale
-	-	-	-	-	-

Pranë zyrave me një ndalesë, në qendër dhe në njësiti administrative, janë bërë 140 kërkesa nga qytetarët për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Numri më i madh i kërkesave i përket Njesisë Administrative Velipojë. Bashkia Shkodër i ka dërguar Prefekturës së Qarkut Shkodër, informacion të detajuar për vlerësimin e ndërtesave publike dhe private, të dëmtuara gjatë tërmetit. 34 objekte janë radhitur sipas vlerësimit të pasqyruar në aktet e konstatimit, duke marrë në konsideratë shkallën e rrezikshmërisë dhe nevojën prioritare për ekspertizë të thelluar.

Tabela 4: Rastet e Dhunës në Familje

Nr. Raportime të dhunës në familje	Burra	Statusi i martuar/i divorcuar/ i ve/ beqar me fëmijë)	Gra	Statusi (e martuar/e divorcuar/ e ve/ beqare me fëmijë)	Jetojnë në zonë urbane/ rurale
6			6		

Rastet janë pajisur me urdhër mbrojtje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër . Gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2019 Bashkia Shkodër ka trajtuar 4 raste të reja me urdhër mbrojtje.

Pas datës 9 Mars 2020 janë mbështetur me paketat ushqimore dhe paketa higjienike 135 familje të komunitetit rom të vendosur në vendqendrimet pranë Prokurorisë , Zallit të Kirit, përtej Bunës , pranë lumit Drin, Tophane dhe në Beltojë. Gjithashtu rreth 352 familje egjiptiane jane mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike, të vendosura në lagjen Liri dhe përtej Bunës.

Tabela 5: Personat e moshës së tretë të asistuar nga bashkia

Nr. i personave të moshës së tretë	Burra	Gra	Jetojnë në zonë urbane/ rurale	Njësia administrative
100				

Nga të dhënat që kemi në qendrat Komunitare "Për familjen" në territorin e Bashkisë Shkodër dhe të dhënave që kanë ardhur në numrin e telefonit të vënë në funksion gjatë emergjencës COVID - 19 janë identifikuar rreth 100 persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe në vështirësi. Specialistët janë në kontakt të vazhdueshëm me këta persona dhe sipas nevojës janë ofruar pako ushqimore dhe higjienike, shërbimin e blerjeve të produkteve të ndryshme sipas nevojës, informacion për procedurën e tërheqjes së pensionit , të sigurimit të medikamenteve etj.

Jetimet edhe pa status, janë pjesë e vazhdueshme e punës së bashkisë, dhe veçanërisht gjatë emergjencës COVID -19. Gjatë kësaj periudhe, është ofruar mbështetje për mbi 30 familje me produktet bazë të shportës, por edhe këshillim për fëmijët e tyre sipas nevojës.

Dhe vajzat dhe nënat janë ndër kategoritë në nevojë me prioritet të lartë për Bashkinë Shkodër. Si të gjithë grupet e tjera në nevojë ata kanë marrë mbështetje me produktet bazë të shportës. Gjithashtu specialistët e shërbimit social kanë vënë një numër telefonik në shërbim për të ofruar mbështetje psikologjike për individët në nevojë. Gjithashtu me prioritet të lartë po asistojnë dhe familjet që janë në risk të institucionalizimit tek fëmijët ose i kanë fëmijët në institucione rezidenciale. Mbështetja e vazhdueshme me pako ushqimore e higjienike dhe informim për të kërkuar pagesën nga punëdhënësi janë ndër shërbimet kryesore të ofruara.

Tabela 6: Numri i familjeve që kanë marrë pako ushqimore

Nr. i familjeve që kanë marrë ndihma	Jetojnë në zonë urbane/ rurale	Njësia administrative
2270	1351/919	

Aktualisht po punohet intesivisht në sigurimin e produkteve bazë të shportës, në bashkëpunim me donatorë e OJD por gjithashtu po financohen nga burime financiare të emergjencës së buxhetit të Bashkisë.

Bashkia Shkodër gjatë kësaj periudhe ka punuar në mënyrë intensive për t'u gjendur pranë nevojave të qytetarëve ku fokusi i aktivitetit të saj është përqëndruar kryesisht në:

1. Shpërndarjen e pakove ushqimore,
2. Dizifektimin e institucioneve dhe shesheve publike,
3. Disiplinimin e tregjeve dhe sigurisë së lëvizjes së qytetarëve.

Shpërndarja e pakove ushqimore:

Në mënyrë të përditshme janë ndihmuar grupe të ndryshme në nevojë duke i ofruar atyre pako ushqimore me elementët bazë ushqimore.

Fig.1. Foto nga shpërndarja e pakove ushqimore



Dizifektimin e institucioneve dhe shesheve publike:

Në mënyrë sistematike janë dizinfektuar institucione të ndryshme publike

Fig.2. Foto nga dizifektimi i institucioneve publike



Disiplinimin e tregjeve dhe sigurisë së lëvizjes së qytetarëve.

Kujdes i është kushtuar tregjeve, sistemit të tyre dhe respektimit të kushteve higjieno sanitare

Fig.3.Foto nga dizifektimi i tregjeve dhe shesheve publike



Bashkia Shkodër nëpërmjet Projekt-Vendim nr.86, datë 19.03.2020 ka kërkuar të përjashtojë për një periudhë tremujore nga pagesa e taksës së pronës dhe tarifat vendore (pastrim, ndricim, gjelbërim publike) si dhe kamatëvonesat kategoritë e taksapaguesve: individë, familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF dhe institucione publike.

Bashkia Shkodër është i vetmi Institucion publik në Shqipëri i cili në situatën e Pandemisë Globale të COVID-19 ka kërkuar lehtësi fiskale për sektorin e shoqërisë civile ndonëse një propozim i tillë ende nuk është shqyrtuar nga Këshilli Bashkiak Shkodër!*

Në funksion të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve Bashkia Shkodër nëpërmjet Vendimit nr.92, datë 13 Prill 2020 ka vendosur marrjen e disa masave shtesë për të takon lëvizjes së qytetarëve, disiplinimit të tregjeve si dhe të bizneseve. Një vendim i tillë ka ndikuar për rritjen e sigurisë në tregje si dhe në lëvizjen e qytetarëve në sheshe publike.

Bashkia Shkodër në funksion të mbrojtjes dhe parandalimit të përhapjes së COVID-19 nëpërmjet shkresës nr.5564 Prot, datë 15.04.2020 i ka kërkuar Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut Shkodër, marrjen e masave shtesë për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes së COVID 19.

Nëpërmjet Vendimit nr.4, datë 24.04.2020, të nënshkruar nga i Deleguari i KNEC-Qarku Shkodër, z.Besfort Lamallari janë marrë disa masa shtesë kryesisht në disiplinimin e tregjeve.¹

Përshkruar mësimet nëpërmjet materialeve foto dhe një pjese të vendimeve dhe shkresave konstatohet se Bashkia Shkodër ka luajtur një rol aktiv në menaxhimin e situatës emergjente të krijuar për shkak të Pandemisë COVID 19. I gjithë aktiviteti i realizuar është pasqyruar gjerësisht në kanalet informuese të Bashkisë Shkodër, faqja e internetit, rrjeti social facebook si dhe Mediat Lokale.

* <https://www.facebook.com/bashkiashkodres/photos/pcb.2544974842275034/2544973908941794/?type=3&theater>

1 <https://www.facebook.com/photo?fbid=2967630299995860&set=pcb.2967631043329119>

Këshilli Bashkiak

Gjatë periudhës Mars-Prill Këshilli Bashkiak Shkodër është mbledhur 3 herë ku janë marrë gjithsej 5 vendime. Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë zhvilluar online ndërkohë që vendimet e Këshillit Bashkiak Shkodër publikohen rregullisht në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Vendimet_e_Keshillit_169_1.php.

Në vendimet e miratuara janë konstatuar këto problematika nga monitorimet tona.

- 1. Çështja e parë** lidhet me faktin që Këshilli Bashkiak Shkodër ka anashkalur shqyrtimin e Projekt-Vendimit nr.86, datë 19.03.2020 të propozuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër. Nje veprim i tillë në një situatë emergjente ka demonstruar mungesën e bashkëpunimit duke vënë në plan të parë interesat politike dhe jo ato të qytetarëve duke qënë se nga miratimi i atij projekt vendimi do të përfitonin grupe të ndryshme duke përfshirë edhe OJF-të e Bashkisë Shkodër.
- 2. Çështja e dytë** lidhet me atë se projekt rezoluta e miratuar nga Këshilli Bashkiak Shkodër më datë 03 Prill 2020 me vendimin nr.16, nuk i është nënshtruar në asnjë rast procesit të konsultimit duke rezultuar më tepër një dokument i hartuar për interesa politike sesa në mbrojtje të intirest të qytetarëve. Projekt-rezoluta në mënyrë flagrante kërkon të anulohen fondet e përcaktuara për aktivitete artistike dhe kulturore si dhe investimet në sport.
- 3. Çështja e tretë** lidhet me faktin që Këshilli Bashkiak në asnjë rast nuk ka krijuar mundësi komunikimi me qytetarët për të dëgjuar shqetesimet e tyre si dhe për të konsultuar dhe dëgjuar mendimet e qytetarëve në lidhje me vendimet që dërgohen për miratim.
- 4. Çështja e katërt** lidhet me faktin se nuk ka iniciativa të ndonjë këshilltari apo grupi këshilltarësh për të adresuar vëmendje të shtuar ndaj grupeve të caktuara në nevojë, duke mobilizuar shpërndarje ndihmash apo duke i bërë thirrje institucioneve qendrore për vëmendje më të shtuar.
- 5. Çështja e pestë:** Vendimin nr.20, datë 23.04.2020 "Për Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Model Rregulloreve" i miratuar gjatë mbledhjes së datës 23 Prill 2020 në kushtet e emergjencës dhe Pandemisë Globale përballë nevojave të qytetarëve duket që nuk i përgjigjet situatës dhe kjo perforcon edhe njëherë mendimin tonë se roli i Këshillit Bashkiak Shkodër në këtë situatë ka qënë i shkëputur nga nevojat e qytetarëve duke mbetur në pozitat e një organi pasiv.

Intervistat me qytetarët

Gjatë periudhës Mars-Prill janë realizuar rreth 130 intervista me grupe të ndryshme të banorëve të Bashkisë Shkodër dhe njërive administrative perreth. Sipas intervistave të realizuara rezulton se:

- 67% e të intervistuarve vleresojnë punën e Bashkisë Shkodër
- 72% e të intervistuarve kërkojnë që ndihma financiare të jetë më e madhe
- 59% e të intervistuarve kërkojnë lehtësim të taksave dhe pagesave të ujit dhe dritave
- 78% nuk kanë informacion në lidhje me mbledhjet e Këshillit Bashkiak

Intervistat sipas shtresave të qytetarëve




Fig.4.Grafiku i intervistave të kryera

Nga intervistat e zhvilluara me qytetarët konstatohet një lloj paniku dhe pasigurie në lidhje me situatën e krijuar. Shumica e të intervistuarve vlerësojnë rolin e Bashkisë në këtë situatë ndonëse shumë prej tyre e shohin të pafuqishme. Ato kërkojnë më tepër vëmendje nga qeverisja qendrore qoftë me lehtësimin e masave kufizuese apo edhe me garantimin e mjeteve kryesore të jetesës. Pasiguria e tyre qëndron më tepër në përballimin e jetesës si dhe pagesat për shpenzimet e përditshme sic janë taksat, dritat, ujrato, kreditë etj.

Në qytetin e Shkodrës ka disa biznese fasone ku punojnë qytetarë të shumtë. Ne intervistuam disa prej tyre. Gjatë intervistës ato shprehën se punojnë në kushte aspak të përshtatshme. Shpesh kushtet higjieno-sanitare mungojnë, punonjësit nuk janë të lirë që të shprehin ankesat e tyre pasi kërcënohen me largim nga puna. Ato shprehën se punëdhënësit i kanë detyruar ato të blejnë doreza dhe maska si dhe dizifektantë.

Në intervistë me disa përfaqësues të familjeve të cilat marrin ndihmë ekonomike ato shprehën se e kanë të pamundur të përballojnë jetesën dhe me shumë mundësi pagesa e dritave dhe ujit do të jetë e pamundur nëse nuk lejohen që të levizin nga shtëpia. Ato kërkojnë që shteti të rrisi vlerën e pagesës së ndihmës ekonomike. Disa prej tyre punojnë në punë të pasiguruar dhe kjo situatë i ka lënë në kushte kur as nuk mund të sigurojnë punë dhe as nuk mund të përfitojnë nga paketa e ndihmës ekonomike.

Në intervistë me administratorë të bizneseve ato theksojnë se në kushte kur biznesi është i mbyllur pagesat e qirave, taksave dhe tatimeve janë një barrë e shtuar. Disa prej tyre kanë edhe kredi të pashlyera dhe shtyrja e kredive nuk e mendojnë se është një zgjidhje që i ndihmon ato. Një problem tjetër mbetet edhe pagesat e sigurimeve shoqërore dhe pagave të punonjësve të cilët shume prej tyre i kanë nxjerrë të papunë por disa shprehën se duan që të vazhdojnë me ato punonjës por nuk përballojnë shpenzimet.

Nga intervistat me punonjës të cilet punojnë në biznese të lejuara si librari, dyqane rrobash, kepecësh, shërbimesh ato janë të friksuar në lidhje me të ardhmen duke qënë se volumi i punës është zvogëluar ndjeshëm dhe në mënyrë të vazhdueshme ndjehen të kërcenuar se do të humbasin vendin e punës.

Nga intervistat me personat me aftesi të kufizuara ato shprehën se kufizimet i kanë krijuar problem për marrjen e shërbimeve mjeksore. Në disa raste kanë patur vështirësi edhe në marrjen e pagesave dhe kërkojnë që kufizimet të jenë më të lehtësuara për ato dhe kujdestarët e tyre.

Nga intervistat me familjarë konstatohet shqetësimi se atyre u mungon koha e mjaftueshme për të bërë pazaret por edhe për të kryer shërbime të nevojshme sic janë marrja e ilaceve, kryerja e pagesave.

Nga intervistat me perfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian rezulton se ndihmat nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë. Ato janë të shqetësuar se nuk mundën të lëvizin dhe shumica e tyre punojnë të pasiguruar prandaj edhe përballimi i jetesës është shumë i vështirë.

Nga intervistat me student të Universitetit "Luigj Gurakuqi" si dhe nxënës të shkollave të mesme shqetësimi kryesorë është se qëndrimi në shtëpi nuk krijon kushtet e duhura për tu përqëndruar në studimin dhe përvetsimin e lëndëve. Mësimi online nuk konsiderohet i përshtatshëm në këtë kohë pandemie. Ato kërkojnë që mësimi të bëhet në grupe të vogla dhe me stafe të levizshme mësuesish.

Në intervistat e realizuara me sportistë dhe artistë shumica e tyre ndihen të braktisur dhe të lënë jashtë çdo ndihme financiare. Sportistët shprehën se po mbajnë trupin në formë në kushte të shtëpisë dhe nuk është e mjaftueshme por nga ana tjetër ato kërkojnë që të përfitojnë nga skemat e ndihmës ekonomike të shpërndara nga qeveria. Po ashtu edhe artistët theksojnë se ato nuk janë të regjistruar dhe në shumë raste puna e tyre sigurohet nga aktivitete të cilat janë të pasiguruara.

Nga intervistat e realizuara me pensionistë ato mendojnë se skema e ndihmës me grupe vullnetarësh nuk ka funksionuar dhe ato ndihen të vetmuar në kryerjen e shërbimeve apo për të lëvizur në ajër të pastër. Ato kërkojnë që të ketë më tepër hapësira për të lëvizur dhe për të kryer nevojat që kanë për shërbime mjekësore apo për të bërë pazar.

Rekomandime

- Bashkia Shkodër duhet që të krijojë në këtë situatë emergjente të gjithë mekanizmat e nevojshëm për të marrë mendimin e qytetarëve dhe grupimeve të ndryshme duke krijuar një frymë solidariteti me baze në komunitet
- Duhet gjetur të gjitha mënyrat e mundshme për angazhimin e komunitetit për të siguruar stabilitet, efektivitet në zbatimin e masave dhe në shmangien e çdo forme ndëshkimore
- Krijimin e të gjitha kushteve të duhura për qytetarët që të mbrojnë shëndetin e tyre dhe të komuniteteve nga frika prej papunësisë kostove të kujdesit shëndetësor, mungesës së infrastrukturës sanitare dhe kështu me radhë.
- Të sigurohet qasje në përkujdesje falas ose të përballeshme për personat më të prekshëm dhe më të vështirë për t'u arritur.
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Shkodër duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Kufizimet e ndërmarra duhet të jenë për një kohë sa më të shkurtër duke krijuar të gjitha kushtet dhe mundësitë e duhura që qytetarët të punojnë, të marrin shërbime dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre.
- Rishikimi i buxhetit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme dhe të argumentuar duke patur gjithmonë si prioritet gjithpërfshirjen e komuniteteve në mjetet e domosdoshme për jetesë.
- Në këtë periudhë është e nevojshme që të mënjanohet retorika politike dhe në fokus të jetë shërbimi ndaj qytetarëve duke i dhënë atyre besimin e nevojshëm për të përballuar këtë emergjencë në menyrë dinjitoze.
- Komuniteti Rom & Egjiptiane, dhe sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese duhet që të trajtohen në menyrë prioritare duke shikuar mundësinë e ndihmës jo vetëm me pako ushqimore por edhe me mjete financiare.
- Duhet të krijohen mundësi për ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe ligjore për viktimat e dhunës në familje, grupet vulnerable për të parandaluar raste të dhunës në familje, shtimit të kriminalitetit apo edhe abuzimeve me alkolin dhe drogat.
- Masat kufizuese duhet krijohet mundësia që zbatimi i tyre mos të jetë vetëm nëpërmjet policisë bashkiake por edhe me ndërgjegjësimin e qytetarëve;
- Ndërverprimi me shoqërinë civile të rritet duke mos u fokusuar thjeshtë në shpërndarjen e pakove ushqimore por edhe në realizimin e shërbimeve dhe lehtësimin e aksesit për grupet në nevojë për përfitimin e këtyre shërbimeve
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t'ua lehtësojnë mësimnxënien.
- Një vëmendje e veçantë duhet adresuar ndaj komunitetit të sportistëve dhe artistëve të cilët kanë nevojë jo vetëm për mbështetje financiare por edhe për mbështetje morale duke qenë se janë kthyer në një komunitet plotësisht jashtë vëmendjes.

Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Nr.11. Prot

Shkodër, 6.4.2020

KËRKESË PËR INFORMACION

Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit"

Nga: Shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë", Shkodër

Drejtuar: Znj.Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me masat e marra për popullsinë në zonat rurale dhe urbane të Bashkisë Shkodësr në situatën e pandemisë COVID-19.

E nderuar Znj.Ademi,

Uroj të jeni mirë me shëndet e punë. Ju ndjekim vazhdimisht në punën tuaj të përditshme dhe ju përgëzojmë për gjithshçka jeni duke bërë për Bashkinë tonë në përgjithësi e në këtë periudhë të vështirë të pandemisë për shkak të COVID-19.

Duke marrë parasysh situatën aspak të zakonitë që bota në përgjithësi dhe Shqipëria në veçanti po kalon prej pandemisë COVID-19, organizatat e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), të krijuar gjatë zgjedhjeve Parlamentare 2013 janë duke monitoruar situatën e qasjes së pushtetit vendor pranë komunitetit në 9 bashki të vendit² si dhe mbledhjet e Këshillave Bashkiakë dhe vendimet e tyre.

Bashkia e Shkodër, monitorohet nga Organizata "Intelektualet e rinj, Shprese" Shkodër.

Me masat e marra nga qeveria shqiptare në lidhje me përballimin sa më të mirë të kësaj situatë, një zë të veçantë ka edhe mbështetja për komunitetin dhe grupet në nevojë, qoftë kjo mbështetje ekonomiko - financiare, shëndetësore apo sociale. Në këtë kuadër, ne do të përgatisim në fillim të muajit Maj 2020 një raport i cili do të përfshijë hapat e marra nga bashkia për zbatimin e vendimeve të Qeverisë Shqiptare dhe rekomandime nga ne për shërbimet e ofruara.

Bazuar në këto masa dhe në zbatimin e tyre pranë komunitetit të Bashkisë Shkodër, do ju luteshim të na informoni bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- Ju lutem na vini në dispozicion vendimet e Këshillit Bashkiak pas datës 9 Mars 2020.
- Sa familje në zonat rurale e urbane janë trajtuar me Ndihmë Ekonomike në Bashkinë Shkodër gjatë muajit Shkurt? A ka patur ndryshime në shtimin e rasteve të familjeve me ndihmë ekonomike pas datës 9 Mars dhe sa është numri i përfituesve? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë që familjet dhe individët e trajtuar nga bashkia juaj, janë identifikuar në territor me probleme të tjera si p.sh. familje me persona me aftësi të kufizuara, fëmijë me autizëm apo tjetër.

- Sa persona, të ndarë sipas gjinisë dhe zonës rurale apo urbane trajtohen me pagesën e paaftësisë për punë (KEMP) të dalë nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP) të invalidëve. A ka patur shtim të tyre pas datën 9 Mars 2020? Në rastet kur kohëzgjatja e KMACP ka përfunduar në këtë periudhë dhe kërkon ribërjen e dokumentave nga e para si është vepruar, a e ka penalizuar në vazhdimin e dhënies së pagesave për këtë kategori? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë, nëse po sa burra e gra janë?
- Sa familje në zonat rurale e urbane, përfitojnë përfitim bonus qeraje? A është shtuar numri i tyre pas datës 9 Mars 2020?
- Sa familje në zonat rurale e urbane kanë mbetur të pastrehë pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019? Sa prej kësaj kategorie marrin bonus qeraje?
- A keni patur e trajtuar raste të dhunës në familje gjatë muajit mars dhe këtë fillim prilli 2020? Nëse po sa raste keni patur? Si është trendi i kësaj periudhe krahasuar me një vit më parë?
- Cilat janë masat e marra për komunitetin Rom dhe Egjiptian pas datës 9 Mars 2020? Sa është numri i familjeve Rome e Egjiptiane, ku janë vendosur ata në Bashkinë Shkodër dhe cilët janë shërbimet dhe mbështetja që ata marrin nga Bashkia?
- Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare shoqëruar me izolim të detyrueshëm, a keni identifikuar persona të moshës së tretë që jetojnë, që nuk kanë askënd të afërm, apo i kanë fëmijët jashtë vendit? Sa është numri i tyre i ndarë sipas gjinisë? Cilat janë masat që ka marrë Bashkia Shkodër për këtë kategori?
- Sa është numri i individëve me statusin e jetimit të ndarë sipas gjinisë, që jetojnë në Bashkinë Shkodër? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Sa vajza – nëna ka në Bashkinë Shkodër? Në cilat njësi administrative janë të vendosura? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse Po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Gjatë identifikimit në territor me grupet e punës a keni ofruar ndihmë për individët e papunë, sa nga keta janë burra dhe sa gra dhe cila është ndihma e ofruar? Keni informacion sa është shtuar numri i tyre pas vendosjes së izolimit/vetëkarantimit prej situatës COVID-19. A keni bërë një projeksion të papunësisë?
- Në sa familje keni dërguar ndihma dhe në cilat zona e fshatra? Sa është rritur numri i familjeve që kanë nevojë për ndihma pas datës 9 Mars, 2020. Çfarë përmbajnë këto ndihma? Sa është sasia normale për një familje dhe si dhe sa here bëhet shpërndarja e tyre?
- A ka patur ndryshim të buxhetit të Bashkisë Shkodër pas vendosjes së masave të marra për situatën COVID-19. Nëse jo, si po përballohet kjo situatë nga Bashkia dhe nëse po si dhe ku janë reflektuar këto ndryshime?
- Referuar kategorisë së të rinjve, a ka ndonjë masë ose kërkesë specifike të ndërmarrë nga Bashkia Shkodër? A ka të rinj të rikthyer nga jashtë Shqipërisë së fundmi pas datës 9 Mars? Çfare shërbimi po ju ofrohet atyre?
- Cilat janë mjetet dhe mënyrat që komunikoni me qytetarët në njësi administrative dhe në qytet për shërbimet që ofroni gjatë periudhës së izolimit/vetëkarantinimit të detyrueshëm?

Ne kemi përgatitur disa tabela të vendosura në aneks të kësaj letre që mund të ndihmojë për mbledhjen e informacionit. Për sa më sipër, sipas kategorive do ju luteshim që të na dërgoni statistikat përkatëse dhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes së masave në këtë kuadër.

Gjithashtu, donim t'ju vinim në dijeni se përpara zgjedhjeve lokale të Qershorit 2019, organizata jonë ka përgatitur Kontratën Sociale, e cila përmban disa prioritetë të cilat janë informuar në aktivitetet tona nga qytetarët e Bashkisë Shkodër. Ne jemi të bindur që ju keni punuar gjatë 2019 dhe po punoni në 2020 për ti realizuar ato, megjithë fatkeqësitë e mëdha natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe COVID-19. Në lidhje me Kontratën Sociale dhe zbatimin e saj ne do të bëjmë një tjetër kërkesë në muajin qershor 2020.

Informacioni i kërkuar më sipër do të ishte një udhëzues edhe për ne si organizatë për të parë mundësinë se si mund të ofrohemi për ndihmë në këto kohë të vështira dhe të pazakonta për të gjithë.

Edhe pse situata është e vështirë, duhet të kemi parasysh të gjithë që komuniteti e ka të nevojshëm informacionin e saktë, sjelljen me dinjitet kundrejt tyre dhe mbështetjen ekonomiko – sociale.

Duke ju uruar punë të mbarë në menaxhimin dhe përballimin e kësaj fatkeqësie natyre, mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,